



Zyra Qendrore, Rr. Xh. Bush #26, 10000 Prishtinë, Kosovë

FTESË PËR OFERTË

Ref no: T-0014-09-2022

Banka ProCredit i fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për:

T-0014-09-2022- “Sherbime te hulumtimit te përvojave te klientëve për nevoja të Bankës ProCredit.”

Të interesuarit mund t’i kërkojnë dokumentet për aplikim prej datës **07 Dhjetor 2022** në e-mail adresën kos.Procurement@procredit-group.com

Vërejtje:

- Banka ProCredit është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen në Euro (€).
- Ofertuesi duhet të paraqesë referenca të saj mbi shërbimet e ngjashme të ofruara më herët.
- Banka ProCredit mban të drejtën të kërkojë informata shtesë nga kompanitë e kualifikuara për ofertim.
- Kompania e përzgjedhur duhet të jetë e gatshme të ofrojë shërbimet në momentin që kërkohet nga banka ProCredit.
- Banka ProCredit ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është **19 Dhjetor 2022, ora 15:00h.**

Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë **T-0014-09-2022- “Sherbime te hulumtimit te përvojave te klientëve për nevoja të Bankës ProCredit”** në Zyrën Qendrore të Bankës ProCredit (Rr. Xhorxh Bush Nr. 26, 10000 Prishtinë).

Çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund ta adresoni në:
kos.procurement@procredit-group.com